



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:045315
Datë: 13.02.2024
Numri i dokumentit: 05319955

KPPP.nr. 1832/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Ndërmarrja “Next” Sh.P.K., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit B.P., avokat nga Prishtina, kundër debitorit N.T.P “Shpeta-2-MA”, me seli në Prishtinë, rr. “Vëllezërit Fazliu”, nr. 409, me bazë përmbartimi sipas dokumentit të besueshëm, pas shqyrtimit paraprak të lëndës, jashtë seancës, me datë 13.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për të vendosur në çështjen juridike përmbartimore në mes të kreditorit Ndërmarrja “Next” Sh.P.K., dhe debitorit N.T.P “Shpeta-2-MA”, me seli në Prishtinë.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Next” Sh.P.K., me Aktvendimin E.nr. 40/14, të datës 18.02.2014, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit N.T.P “Shpeta-2-MA”, me seli në Prishtinë, për pagesën e

detyrimit sipas dokumentit përbarimore në lartësi prej EUR 352.03. Ndërsa, e njejta gjykatë me aktvendimin E.nr40/14, të datës 08.12.2016, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje përbarimore, ndërsa lëndën ia ka dërguar Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin CP.nr. 139/17, të datës 20.02.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje përbarimore dhe lëndën e ka dërguar pranë Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike.

Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, për arsyet si në vijim:

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përbarimore është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Ndërsa, mjetet juridike në procedure përbarimore, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/l-139 për Procedurën Përbarimore (tutje: LPP) janë te përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përbarimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa,”* ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përbarimore. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përbarueshëm për përbarimin me dhunë.”*

Në rastin konkret, lënda e cila është transferuar në këtë gjykatë ka për objekt caktimin dhe zbatimin e përbarimit sipas aktvendimit mbi lejimin e përbarimit, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedurë përbarimore të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-

së. Andaj, në mungesë të mjetit juridik, në kuptim të dispozitave nga neni 13, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbarimore.

Duke marrë parasysh faktin se objekt në këtë çështje përmbarimore është caktimi dhe zbatimi i aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit nga gjykata si organ përmbarues, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë mjet juridik për të cilin Gjykata Komerciale do të ishte e kompetencës për të vendosur, kjo gjykatë vlerëson se pikërisht Gjykata Themelore Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përmbarimore, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për procedurën përmbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVOËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1832/23, datë 13.02.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.